

## VICTORIAN LITERATURE AND THE INFLUENCE OF SCIENCE ON LITERATURE

### LETËRSIA VIKTORIANE DHE NDIKIMI I SHKENCËS MBI LETËRSINË

Suzana IBRAIMI-MEMETI<sup>1</sup>

*1\* Department of English Language and Literature, Faculty of Philology, University of Tetova*

*\*Corresponding author e-mail: suzana.ibraimi@unite.edu.mk*

#### **Përmbledhje**

Mesin dhe gjysmën e dytë të shekullit 19-të anglezët zakonisht e quajnë “periudha viktoriane” (Victorian Age). Për ta fjala ‘viktoriane’ është bërë simbol jo vetëm për karakteristikat e letërsisë së asaj kohe, por edhe për tërë qytetërimin e atëhershëm britanik. Historianët e letërsisë dhe kulturës britanike janë të mendimit se kohëzgjatja e veçorive “viktoriane” nuk pajtohet tërësisht me kohëzgjatjen e sundimit të Mbretëreshës Viktoria (1837-1901), meqë në fillim të viteve të 80-ta bie në sy një shembje e këtij sistemi relativisht stabil të vlerave dhe një depërtim i tendencave të reja.

Periudha viktoriane është një epokë e paradokseve. Ajo ishte një epokë e fesë dhe epokë kundër fesë, një epokë e progresit dhe e optimizmit, dhe një epokë e varfërisë dhe e pesimizmit, një epokë e sundimit të “meshkujve” por edhe një epokë e emancipimit të femrave. Përveç këtyre paradokseve ajo ishte edhe një epokë “par excellence” (e shkëlqyer) e romanit. Prandaj, sundimi i Mbretëreshës Viktoria konsiderohej si një epokë ku e pamundshmja ishte e mundshme dhe e kundërta. Ishte gjithashtu koha kur veprimtaria e frymës shkencore ishte shfaqur në çdo sferë të mendimit dhe të praktikës. Por, dogmatizmi viktorian u gjet në një situatë dilemash dhe vështirësish të mëdha në epokën e shkencës.

*Fjale kyçe:* letërsi viktoriane, roman, kritik letrar, shkencë, shoqëri.

#### **1. Një vështrim i përgjithshëm mbi letërsinë viktoriane**

Letërsia e kësaj periudhe ishte e kushtëzuar nga kuadri i përgjithshëm ideologjik si dhe nga disa faktorë të tjerë. Shkrimtarët e kishin prejardhjen më të shpeshtën e herëve nga borgjezia apo mikroborgjezia dhe në përgjithësi ishin besnikë ndaj pikëpamjeve konvencionale dhe të ndërlikuara, shumë më tepër se sa inteligjenca krijuese e vendeve të tjera të Evropës. Mirëpo, ata tashmë ndiheshin dhe identifikoheshin si një shtresë e veçantë e shoqërisë, të thirrur për ngritjen morale të bashkëqytetarëve, prandaj shumica e tyre kishin qëndrim kritik ndaj shoqërisë, sidomos ndaj qëndrimeve sentimentale të Karlajlit.

Të gjithë krijuesit ishin të mendimit se letërsia ka një qëllim tejet të rëndësishëm edukativ, edhe pse me kalimin e kohës u shfaq edhe esteticizmi në forma të ndryshme. Pothuajse asnjëri nuk i cënoi seriozisht 'tabut' e përmendura ideologjike dhe morale, dhe si rrjedhojë këndvështrimi i njëanshëm ndaj botës ishte më i madh në periudhat më të herëshme; dhe meqë ky këndvështrim ishte një këndvështrim esencial borgjez, atëherë kjo letërsi e asaj periudhe mund të quhet si viktoriane dhe borgjeze. Ajo ishte e tillë me publikun dhe lexuesit të cilëve u drejtohej ngaqë, megjithëse shkrimtari shkruante për popullin dhe njëkohësisht i drejtohej edhe "lexuesit" në përgjithësi, ndonse publiku i lexuesve po rritej, shkrimtari e kishte gjithnjë ndërmend atë pjesë të popullit që përbëhej nga të ashtuquajturit "xhentëlmënë".

Shumica e shkrimtarëve kishte parasysh shijen e publikut të cilit i drejtohej dhe të cilin e përfaqësonte. Me këtë rast, për popullaritetin e veprave letrare një rol të veçantë kishte si kritika letrare ashtu edhe numri i madh i revistave letrare. Në përgjithësi, mund të thuhet se e tërë letërsia e kësaj epoke deri në fillimin e Luftës së Parë Botërore, mund të quhet edhe si vazhdim i romantizmit. Disa rezultate të periudhës së mëparshme të letërsisë romantike definitivisht e pushtuan publikun për një kohë të gjatë përmes imagjinatës magjepsëse, ekzotikes, ndjenjës subjektive, adhurimit të natyrës dhe vlerësimit të lartë të origjinalitetit.

Këto veçori ende vlerësoheshin në këtë periudhë. Mirëpo, publiku njëkohësisht, në pajtim me frymën pozitiviste dhe utilitariste të kësaj periudhe, kërkonte besnikërinë ndaj jetës dhe vlerësonte veçanërisht ata shkrimtarë dhe shkrimtare që personazhet e tyre i kishin krijuar sipas modeleve të gjalla. Lexuesit kërkonin nga vepra letrare porosinë apo mesazhin e caktuar. Afërmendsh, ajo porosi duhej të ishte në përputhje me vlerat e përgjithshme morale (Legouis, 1097, Burges, 178). Ndër gjinitë letrare, poezia me autoritetin e saj vazhdoi për njëfarë kohe të mbante vend parësor, por jo edhe me përhapjen e veprave midis lexuesëve të shumtë. Tashmë, vendin e parë e kishte zënë romani. Romani në këtë periudhë kishte ndërtuar disa norma të veçanta të cilat mbetën të pandryshueshme deri në fund të shekullit.

Këto norma ishin krijuar nën ndikimin e mënyrës së botimit dhe qarkullimit të romanit. Romanet, më të shpeshtën e herës botoheshin më parë me fashikuj në revista dhe pastaj botoheshin si një libër i tërë. Një pjesë e tirazhit të librave e merrnin bibliotekat publike për ta përhapur librin tek lexuesit. Si rrjedhojë kishte edhe raste të botimit të romaneve me ndonjë dobësi të kompozicionit. Po kështu, aso kohe romani botohej në tre libra dhe duhej të ishte voluminoz. Sa i përket temave, ato duhet të ishin standarde, zakonisht preferoheshin tema e dashurisë, përfundimet e lumtura ("happy ends") dhe pavarësia e qëndrimit të shkrimtarit.

## 2. Ndikimi i shkencës

Kur Tomas H. Hakësllin në vitin 1894 e pyetën se si do të emërtohej ardhmëria në shekullin e 19-të, a do të quhej epoka e Darvinit, epoka e Gledstonit apo epoka e Pastnërit, ai nuk qe në gjendje të jepte një emërtim ndonse ishte i bindur se shekulli 19-të më së miri do të emërtohej si epoka e shkencës: "Unë besoj se karakteristika kryesore e shekullit 19-të ishte zhvillimi i hovshëm i frymës dhe i veprimtarisë shkencore, zbatimi ose aplikimi konsekuent i metodave shkencore në hetimin dhe gjurmimin e të gjitha problemeve me të cilat ishte marrë mendja njerëzore dhe njëkohësisht do t'i flakte të gjitha idetë të cilat ishin treguar të paaftha për t'u hulumtuar dhe gjurmuar.

Veprimtaria e frymës shkencore ishte shfaqur në çdo sferë të mendimit dhe të praktikës." (Day 13) Afërmendsh, dogmatizmi viktorian u gjet në një situatë dilemash dhe vështirësishë të mëdha në epokën e shkencës. Zhvillimi i shkencës kishte kontribuar në rritjen e komfortit material, ndërsa natyra e kthjellët dhe faktike e shkencës i pëlqente mendimit borgjez. Ç'është e vërteta, shumë shkencëtarë të shekullit 19-të në Angli e kishin prejardhjen nga klasa e mesme. Po kështu bindja e thellë viktoriane në idenë e progresit si duket mbështetej në teorinë e evolucionit (Altick, 15-34).

Vepra e Lajëllit “Principles of Geology” (parimet e gjeologjisë, 1830) solli një mori faktesh mbi evolucionin në shtresat e rruzullit tonë. Tenisoni ishte tejet i impresionuar me këtë vepër. Kjo vepër me të vërtetë ndikoi në mbarë botën anglishtfolëse. “Vestiges of the Natural History of Creation” (“Gjurmët e historisë natyrore të krijimit,” 1844) nga Robert Çembërs, emri i të cilit ende përmendet në enciklopedinë angleze të Çembërsit, e popullarizoi konceptin e evolucionit biologjik në përgjithësi. Mirëpo, evolucioni ende kishte mbetur dërdëllitje sallonesh dhe debatesh intelektuale deri te paraqitja e Çarlz Darvinit.

Rezultatet e veprës së Darvinit ndikuan shumë për sqarimin e procesit të evolucionit. Ndikimi i tij ishte i mahnitshëm, por ndonse konflikti i vërtetë midis shkencës dhe fesë nuk e shqetësonte Darwinin, kjo polemikë i përfshiu fuqishëm qarqet intelektuale angleze. Pa marrë parasysh sa ishte i justifikueshëm debati, një numër shumë i madh i njerëzve nxorën këto përfundime nga mesazhet e Darvinit:

(1) Sipas mesazheve të veprës së Darvinit, rrëfimi për krijimin e botës ashtu siç e paraqet bibla ishte krejtësisht i pasaktë. Sipas darvinizmit, Bibla ishte një lloj vepre poetike dhe folklorike. Së këndejmi, porositë e Biblës mund të gërshetoheshin me antropologjinë dhe prozën imagjinative.

(2) Tërë koncepti mbi krijimin e botës ishte i rrejshëm. Përgënjeshtrimi i kësaj ideje tingëllonte si një indinjatë e pafalshme. Revolucioni i Kopernikut e kishte zhvendosur planetin tonë prej pozitës së qendrës së universit në një status të një sateliti të vogël që sillet rreth një ylli mesatar. Njëherësh, darvinizmi e zhvendos edhe njerëzinë nga roli i tij në botë. Sipas darvinizmit njeriu ishte një kafshë superiore por megjithatë ishte kafshë.

(3) Ideja mbi shpirtin njerëzor ishte false, ndërsa besimi në pavdekshmëri është një mashtrim. Vdekja e qenies njerëzore, në fakt zhdukja e njerëzimit, nuk do të ishte më një proces i evolucionit kozmik.

(4) Krijuesi i universit, nëse ekziston, është i papërcaktuar.

Duhet theksuar se këto supozime nuk ishin të Darvinit dhe nuk ishin shpallur nga asnjë shkencëtar. Mbështetësit zhurmashin të këtyre ideve ishin laikët progresivë ndërsa në të vërtetë shumica e këtyre ideve vinin nga njerëzit religjioz, veçanërisht klerikët, të cilët përpiqeshin ta demaskonin darvinizmin si një blasfemi. Nëse në shekullin 20-të polemikat rreth darvinizmit kishin marrë fund prej kohësh, nuk duhet harruar se në shekullin 19-të ato ishin shumë të bujshme. Shumë viktorianë të ndërgjegjshëm humbën besimin ndërsa një numër i njerëzve fetarë e konsideronin shkencën si një veprimtari të urryer e cila sulmonte fenë.

Disa nga autorët më me zhurmë të asaj periudhe, p.sh. Brauningu dhe Thekëri, ishin pothuajse indiferentë ndaj konceptit të evolucionit. Si duket edhe Dikensi kemi përshtypje se nuk kishte dëgjuar për Darvinizmin. Dizraeli shakaxhi, duke i kritikuar ithtarët e evolucionit të vitit 1864, tregonte këtë anekdotë: “Ta marrim vesh: a është njeriu majmun apo engjëll? Im Zot sa për mua, unë jam në anën e engjëjve”. Mirëpo shumica e viktorianëve mund të kuptohen edhe më mire kur dihet se kanë pasur këto kundërthënie. Pothuajse shumica prej tyre ishin të bezdisur me këto polemika; disa ndër ta, si Tenisoni, e ndërruan fenë, ndërsa të tjerët, si Kllau, humbën pothuajse çdo gjë që kishte të bënte me fenë dhe jetuan në vuajtje, ndërsa edhe të tjerë si Merëditi, i përqaftuan idetë evolucionare me kënaqësinë më të madhe.

Sa i përket epokës viktoriane në përgjithësi, mund të përmendim G. Jangun i cili ka thënë në vitin 1945 se bota ka qenë dëshmitare e dy epokave madhështore të intelektit njerëzor: njëra është epoka e Perikliut (demokracisë antike), kurse epoka tjetër është ajo viktoriane. Që në vitin 1922 Din Ingëlbëll theksonte se shekulli 19-të “është shekulli më i mrekullueshëm në historinë njerëzore”. Për të kuptuar më mire periudhën viktoriane duhet të jemi të vetëdijshëm se ajo përmbante në vetvete si radikalizmin e trashëguar ashtu edhe rrëkenë e ideve të shumta dhe të reja.

## Përfundim

Arritjet teknike dhe materiale të Britanisë viktoriane, fal shpikjeve dhe zbulimeve teknologjike e bënë Mbretëreshën Viktoria sundimtaren e një epoke që po premtonte një progres të shkëlqyer dhe optimizëm. Prandaj, viktorianët nuk nguronin për ta përshëndetur këtë periudhë me buzë në gaz dhe me besim në revolucionin industrial dhe në filozofitë në të cilat mbështetej ajo. Kjo rridhte nga fakti se revolucioni industrial solli teknika të reja dhe efikase dhe e nxiti përmirësimin e standardit të jetës dhe begatisë së mallrave duke e bërë Britaninë e Madhe “qendrën e gjithësisë”.

Me rënien e bujqësisë, shumë fshatarë u zhvendosën nëpër qytete për të kërkuar punë dhe kushte më të mira jetese. Në këtë mënyrë u rritën disa qytete, dhe u përhap edhe diversiteti gjuhësor, racial dhe kulturor. Londra u bë shënjestra e shumë emigrantëve dhe vizituesve si nga Evropa ashtu edhe nga pjesë të tjera të botës (Pollard, 24-30).

## Referencat

- [1]. Adams, J. Eli. *A History of Victorian Literature*, Clichester West Cambridge, 2012.
- [2]. Albert, E. A. *History of English Literature*, Hong Kong, 1985.
- [3]. Altick, R. D. (1973). “The Weaker Sex”, *Victorian People and Ideas: A Companion for the Modern Reader of Victorian Literature*. New York: Norton.
- [4]. Burgess, Anthony. *English Literature*, Longman, London, 1974.
- [5]. Brontë, C. (2003). *Jane Eyre*, Shanghai World Books Publishing House.
- [6]. Conley, Carolyn A. *The Unwritten Law: Criminal Justice in Victorian Kent*: Oxford UP, 1991.
- [7]. Cruttendan, Aidan. *The Victorians, Facts and Files*, London 2003.
- [8]. Cunningham, Gail. *The New Woman and the Victorian Novel*. London: Macmillan Press, 1978.
- [9]. Daiches, David. *A Critical History of English Literature, Volume II*, London, Secker and Warburg, 1963.
- [10]. Ellis, Sarah. *The Mother’s of England: Their Influence and Responsibility*, London, Fisher and Son, 1843.
- [11]. Elizabeth, T. Charlotte. *The Wrongs of Woman*. Part I. Milliners and Dressmakers. New York: M.W. Dodd, 1845.
- [12]. Emsley, Clive. *Crime and Society in England 1750- 1900*, New York, Longman, 1987.
- [13]. Ewbank, Inga-Stina. (1966). *Their Proper Sphere: A Study of the Brontë Sisters as Early Victorian Female Novelists*. The Camelot Press Ltd., London and Southampton.
- [14]. Foster, Shirley. *Victorian Women’s Fiction: marriage, Freedom and the Individual*, London, 1985.
- [15]. Legouis, Emilie. *A Shory History of English Literature*, The Clarendon Press, Oxford, 1978.
- [16]. Long, William. *English Literature*, Ginn and Company, London, 1972.
- [17]. Lyall, Edna. “Mrs. Gaskell.” *Women Novelists of Queen Victoria’s Reign: A Book of Appreciation*.Ed. Margaret Oliphant. 1897. Cambridge: Cambridge UP, 2011. 117-145.
- [18]. Morris, Virginia. *Double Jeopardy Woman Who Kill in Victorian Fiction?*, Lexington UP of Kentucky, 1990.
- [19]. Mulock, Dinak. *John Halifax, Gentlemen in 1857 in Pollard’s Victorians*, 1993.
- [20]. Nead, L. 1988. *Myths of Sexuality: representation of women in Victorian Britain*. Oxford: Blackell.
- [21]. Pollard, Arthur (1965). *Mrs. Gaskell: Novelist and Biographer*. Manchester University Press. p. 12. ISBN 0-674-57750-7.
- [22]. Watt, George. *The Fallen Women in the Nineteenth Century English Women*, London, 1984.